

"INTER TRADE & DISTRIBUTION" SH.P.K.

Regjistruar në QKR: dt. 24.03.2009.

NUIS: K91524002L.

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, Shqipëri.

EKSTRAKT I VENDIMIT
TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"INTER TRADE & DISTRIBUTION" SH.P.K.
Nr. 25, Datë 18.04.2024.

Sot, më datë 18.04.2024, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "INTER TRADE & DISTRIBUTION" sh.p.k., me adresë në: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, më datë 24.03.2009, me NUIS K91524002L, e përbërë nga zotëruesit e 100% të kuotave të kapitalit:

1. **Shoqëria me Pëgjegjësi të Kufizuar "Investment Joti – Infosoft Group"**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Znj. Blerta Elezaj, e cila zotëron 52% të kapitalit të Shoqërisë.
2. **Z. Plarent Kristo**, i cili zotëron 24% të kapitalit të Shoqërisë.
3. **Z. Roland Joti**, i cili zotëron 24% të kapitalit të Shoqërisë.

Duke qenë se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve plotëson kuorumin e caktuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Asambleja ka për rend dite:

- Diskutim në lidhje me zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k.

Në përputhje me nenin 9.8 të Statutit të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k., i ndryshuar më dt. 06.12.2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k. nga 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të kuotës së secilit Ortak, në përputhje me përqindjet respektive të pjesëmarrjes së Ortakëve në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Në përfundim të procesit të zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k., kapitali i regjistruar i saj bëhet 1,000,000 (një milion) lekë. Vlera prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë me të cilën zvogëlohet kapitali do t'u paguhet Ortakëve në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në kapital. Përqindjet respektive të pjesëmarrjes së Ortakëve në kapital nuk do të ndryshojnë, ndërsa vlera nominale e kuotës për secilin prej Ortakëve do të ndryshojë si më poshtë:

Nr.	Ortakët	Vlera e kapitalit para zvogëlimit		Vlera e kapitalit pas zvogëlimit	
		Vlera nominale (lekë)	Në %	Vlera nominale (lekë)	Në %
1.	Investment Joti – Infosoft Group sh.p.k.	780,000	52%	520,000	52%
2.	Plarent Kristo	360,000	24%	240,000	24%

3.	Roland Joti	360,000	24%	240,000	24%
TOTALI		1,500,000	100%	1,000,000	100%

3. Vlera prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë me të cilën zvogëlohet kapitali i shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k. rezulton nga kontributet në para të Ortakëve të Shoqërisë, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 84, dt. 11.04.2019, për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me kontribute monetare të Ortakëve. Në përputhje me Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", duke qënë se është zvogëlim i kapitalit qe rrjedh nga kontributet në para të Ortakëve, mbi vlerën e sipërcituar nuk aplikohet mbajtja e tatimit në burim.
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore.
5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, departamenti ligjor dhe departamenti i financës për ekzekutimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT

"Investment Joti-InfoSoft Group" sh.p.k.

Blerta ELEZAJ



Plarent KRISTO

Roland JOTI

